




Pranuar / Dorezuar Punimjen/Prodato Received/Delivered	15.03	2022	2	viti god year
Organ /Njësia Organ /Jednica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Pilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKIMSHICK	1384/2022		1/4	



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.72/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Jeton Koca-anëtarë, me Rushit Kajtazi Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr.72/2021 të datës 28.01.2022 të parashtruar nga ankuesi [redacted] me adresë [redacted] Komuna e Hanit të Elezit, kundër organit të punësimit/Komuna e Hanit të Elezit, në çështjen juridike "mase disiplinore/vërejtje, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 14.03.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet si e pabazuar ankesa A.nr.72/2022 e datës 28.01.2022, e parashtruar nga ankuesi [redacted]
- II. Mbetet në fuqi masa disiplinore "Vërejtja" më numër protokoll 03/366 e datës 18.01.2022, e shqiptuar ndaj ankuses nga Kryetari i Komunës së Hanit të Elezit.

A r s y e t i m

Ankuesi [redacted] i punësuar në Komunën e Hanit të Elezit, me datë 28.01.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokoll në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër masës disiplinore "Vërejtja", e shqiptuar nga Kryetari i Komunës së Hanit të Elezit me datë 18.01.2022, me pretendimet ankimore se kjo vërejtja nuk është lëshuar me ndonjë bazë ligjor, dhe kështu Kryetari i Komunës së Hanit të Elezit ka vepruar në kundërshtim me Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe Ligjin Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (tutje referuar Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 09.02.2021, ka proceduar

kërkesën për përgjigje në ankesë të Hani i Elezit. Ndërsa me datë 18.02.2022, Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë të ankuesit si dhe shkresat lidhur me lëndën.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 387/2022, të datës 28.01.2022, e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Masën disiplinore "Vërejtja" e shqiptuar ndaj anësueses përmes shkresës më numër protokollit 03/366 të datës 18.01.2022 të Kryetarit të Komunës së Hanit të Elezit; E-maili i datës 12.01.2022 nga [redacted] dërguar ankuesit [redacted] E- maili i datës 27.1.2021 dërguar nga [redacted] tek [redacted] Autorizimin e datës 10.01.2022; Raport specialistik për ankuesin i datës 06.01.2022; emailin e datës 26.01.2022 nga [redacted] për ankuesin lidhur me vijueshmërinë në punë të ankuesit sipas kërkesës së datës 25.01.2022, Listën e Evidencës në punë të ankuesit për periudhën 08.12.2021 deri me 20.01.2022; E- maili i datës 20.01.2022 dërguar nga ankuesi [redacted] tek [redacted] Akt Emërimi i datës 30.12.2011, i ankuesit [redacted] Formuari për Vlerësimin e Rezultateve në punë për vitin 2020 për vlerësimin e ankuesit; Përgjigje në ankesë me numër protokollit 841/2022 e datës 18.02.2022; shkresë më numër 02-1174/2022 e datës 16.02.2022; e- maili i datës 13.01.2022 dërguar nga [redacted] tek [redacted] Pasqyra e punëtoreve për përudhën 01.01.2022 deri 31.01.2022 për ankuesin; Procesverbali i datës 10.05.2016, i Bordit të Drejtoreve; Procesverbali i datës 29.07.2016, i Bordit të Drejtoreve; Procesverbali i datës 15.06.2016, i Bordit të Drejtoreve; Procesverbali i datës 18.07.2019, i Bordit të Drejtoreve; Procesverbali i datës 30.07.2019, i Bordit të Drejtoreve; Procesverbali i datës 10.12.2021, i Bordit të Drejtoreve; Procesverbali i datës 17.12.2021, i Bordit të Drejtoreve; Procesverbali i datës 28.12.2021, i Bordit të Drejtoreve; Procesverbali i datës 11.01.2022, i Bordit të Drejtoreve; Procesverbali i datës 13.01.2022, i Bordit të Drejtoreve; Procesverbali i datës 21.01.2022, i Bordit të Drejtoreve; Procesverbali i datës 28.01.2022, i Bordit të Drejtoreve; Procesverbali i datës 04.02.2022, i Bordit të Drejtoreve; Procesverbali i datës 07.02.2022, i Bordit të Drejtoreve; E-mail i datës 07.03.2021 nga Ajete Berisha për KPSHCK-në se bashku me vijueshmërinë në punë të ankuesit nga 08.12. 2021 deri 28.02.2022 dhe dosja e pushimit mjekësor.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar dhe analizuar provat e parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankuesit [redacted] është e pabazuar, sepse:

Sipas vlerësimit të shkresave të lëndës rezulton se ankuesi sipas Akt Emërimit të datës 30.12.2011, ushtron pozitën e punës Shef i Zyrës së Prokurimit, në Komunën e Hanit të Elezit. Ndaj të njëjtit, Kryetari i Komunës së Hanit të Elezit në cilësi të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të ankuesit, me datë 18.01.2022 ka shqiptuar masën disiplinore "vërejtje" për shkak të mos respektimit të orarit të punës respektivisht për shkak se i njëjti me datë 12.01.2022 gjatë orarit të punës nuk është gjetur në vendin e tij të punës duke shkuar në Prishtinë pa paralajmërim të eprorit të tij, në fund vit ku ka pas ngarkesë të madhe të punës ankuesi ka shkuar në pushim vjetor dhe se i njëjti ka refuzuar që të merr pjesë dhe të raportoj në mbledhjet e Bordit të Drejtoreve.

Ankuesi në ankesën e tij të parashtruar në Këshill, pretendon se masa disiplinore "Vërejtja", e shqiptuar nga Kryetari i Komunës së Hanit të Elezit me datë 18.01.2022, nuk është lëshuar me ndonjë bazë ligjor, dhe kështu Kryetari i Komunës së Hanit të Elezit ka vepruar në kundërshtim me Ligjim Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe Ligjin Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative. Me tej thekson se ka respektuar me përpikëri orarin e punës dhe se



edhe pse ka qenë në pushim mjekësor ka ardhur në punë. Kërkon që Këshilli ta aprovoj ankesën si të bazuar dhe të anulohet masën disiplinore "vërejte" të datës 18.01.2022.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (tutje Kolegji) në funksion të shqyrtimit të pretendimeve të ngritura në ankesë ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë respektivisht nenin 27 paragrafi 3 ku përcaktohet se: *Zyrtari publik është i detyruar të shfrytëzojë orarin e punës me efikasitet dhe vetëm për kryerjen e detyrave të tij të punës.* Ndërlidhur me këtë Rregullorja (QRK) Nr. 12/2020 për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve Publik me nenin 8 ka paraparë se: *Respektimi i orarit të punës 1. Gjatë orarit të punës të gjithë zyrtarët publik janë të obliguar të jenë në vendin e punës. Çdo zyrtar publik shënohet në librin e vijueshmërisë në punë ose në regjistrin elektronik. 2. Mos respektimi i orarit të punës paraqet shkelje disiplinore. 3. Përgjegjës për vijueshmëri në punë të zyrtarëve publik është menaxheri drejtues. 4. Për çdo largim nga vendi i punës gjatë orarit, zyrtari publik duhet të marrë leje menaxheri drejtues, dhe si rrjedhojë në kuptim të këtyre dispozitave ligjore si dhe bazuar në shkresat e lëndës, Kolegji ka konstatuar se ankuesi me datë 12.01.2022 kishte shkuar në AQP në Prishtinë pa njoftim paraprak të mbikëqyrësit të tij. Në kontekst të kësaj, Kolegji bazuar në provat e lëndës nuk ka gjetur asnjë dëshmi nga e cila provohet se ankuesi ka pasur ftesë nga AQP për pjesëmarrje në takimin e datës 12.01.2022, përveç një emaili sqarues të datës 20.01.2022 të përcjell nga Mehmet Rama i lëshuar me kërkesë të ankuesit, Andaj mbi këtë bazë, Kolegji me të drejtë konstaton se janë të pabazuara pretendimet ankimore të ankuesit.*

Duke u bazuar në konstatimin si me lartë, Kolegji vlerëson se Kryetari i Komunës së Hanit të Elezit, me rastin e shqiptimit të masës disiplinore "Vërejte" të datës 18.01.2022, ka zbatuar drejt ligjin material duke cilësuar si shkelje të lehtë disiplinore veprimin e ankuesit lidhur me ngjarjen e datës 12.01.2022 ku i njëjti nuk është gjetur në zyrën e tij, pasi që kishte shkuar në AQP në Prishtinë pa njoftim të eprorit të tij, dhe në këtë mënyrë Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i ankuesit ka vepruar në pajtim me nenin 50 paragrafi 4 dhe 5 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ku përcaktohet se: *Për shkeljet e lehta, jepen masat disiplinore të përcaktuara në paragrafin 1.1 të nenit 47 të këtij ligji. Për çdo shkelje, jepet vetëm një masë disiplinore, si dhe nenin 8 paragrafi 2 të Rregullores (QRK) Nr. 11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë, ku përcaktohet se: Masa disiplinore e përcaktuar në nenin 47 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 i Ligjit jepet nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i nëpunësit civil, nëse nëpunësi ka bërë shkelje disiplinore të përcaktuara në nenin 46 paragrafi 4 nënparagrafi 4.1, 4.2, 4.3 dhe 4.4 të Ligjit.*

Andaj, mbështetur në gjendjen faktike dhe bazën juridike të evidentuar si me lartë, Kolegji pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar me nenin 6 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike:

Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.



KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda m numër A.nr. 72/2022

Rushit KAJTAZI

Procesmbajtës

Ardita HAXHIKAJ DEMI

Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit [REDACTED]
- Kryetarit të Komunës së Hanit të Elezit;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Hanit të Elezit; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së,